VENDIM
Nr. 357, datë 30.12.2022

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "E-VENTO S.R.L ALBANIA" SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 32, DATË 4.2.2021, "MBI KËRKESËN E SHOQËRISË 'E-VENTO S.R.L. ALBANIA' SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 84, DATË 17.7.2008, I NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 53, pika 2 dhe nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2129 prot., datë 29.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021 "Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.4.2021, 'Mbi kërkesën e shoqërisë 'E-Vento S.R.L Albania' sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, 'Mbi kërkesën e shoqërisë 'E-Vento s.r.l. Albania' sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, i ndryshuar",

konstatoi se:

1. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 249, datë 13.12.2021, i ndryshuar me vendimin nr. 269, datë 14.10.2022, ka vendosur:

"1. Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e depozitimit të Deklaratës Mjedisore dhe me 6 (gjashtë) muaj afatin e depozitimit të dokumentacionit pronësor duke filluar ky afat nga data 14.09.2022.

2. Shoqëria "E-Vento s.r.l. Albania" sh.p.k. çdo 3 (tre) muaj të dokumentojë në ERE një progres raport me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara.

3. Shoqëria "E-Vento s.r.l. Albania" sh.p.k. të paraqesë në ERE në mënyrë periodike me data të rifreskuara dokumentet që i nënshtrohen rinovimit të afateve.".

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin e mësipërm me shkresën nr. 167/14 prot., datë 8.11.2022, duke i sjellë në vëmendje detyrimin për të plotësuar në afat sa kërkuar nga ky vendim.

- Në lidhje me kushtin e vendimit nr. 249/2021, i ndryshuar, që ka të bëjë me pajisjen me deklaratën mjedisore, me shkresat e protokolluara në ERE, përkatësisht me nr. 167/15 prot., datë 21.11.2022, nr. 167/16 prot., datë 7.12.2022, nr. 167/17 prot., datë 7.12.2022 dhe nr. 167/19 prot., datë 22.12.2022, shoqëria ka informuar ERE-n dhe ka dokumentuar përpjekjet e saj për t'u pajisur me deklaratë mjedisore, ku nga informacioni i marrë rezulton se aktualisht kjo procedurë është në fazën e dërgimit të mendimit nga institucionet, si: Bashkia Finiq, Konispol, Sarandë dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 167/18 prot., datë 12.12.2022, shoqëria ka bërë me dije se me shkresën e saj nr. 230 prot., datë 6.12.2022, ka kërkuar pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. miratimin e pikës së lidhjes dhe nënshkrimin e aktmarrëveshjes përkatëse, në kuadër të plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 269, datë 14.10.2022, si dhe referuar detyrave të shprehura nëpërmjet konstatimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 111, datë 26.4.2021, ku është përcaktuar se: pas depozitimit të lejes së mjedisit dhe studimit të fizibilitetit, ERE do të vlerësojë më tej mundësinë e shtyrjes, sipas kërkesës së shoqërisë, të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 84/2008, i ndryshuar, konkretisht sipas pikës 1, germa "b", që ka të bëjë me marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. dhe sipas pikës 1, germa "d", që ka të bëjë me kohën e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës.

- Për gjithë sa më sipër, rezulton se shoqëria nuk ka arritur ende të përmbushë kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 249/2021, i ndryshuar, *që ka të bëjë me pajisjen me deklaratën mjedisore,* por ka informuar dhe dokumentuar në ERE të gjitha përpjekjet që varen nga vullneti i saj dhe po ashtu statusin në të cilën ndodhet pajisja me këtë dokument.

- Në këto rrethana, duke vlerësuar përpjekjet e shoqërisë dhe informacionin e dokumentacionin e depozituar nga ana e saj në mënyrë periodike në ERE, vlerësojmë që të shtyhet dhe me 3 (tre) muaj të tjerë afati brenda të cilit shoqëria të pajiset me deklaratën mjedisore, aq sa ishte dhe afati fillestar i lënë në dispozicion të saj, afat i cili fillon nga data 15.12.2022.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021, ndryshon si vijon:

"2. Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e depozitimit të deklaratës mjedisore dhe me 6 (gjashtë) muaj afatin e depozitimit të dokumentacionit pronësor duke filluar ky afat nga data 15.12.2022.".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti